

PETRIT NATHANAILI

## KONCEPTE TË ELITËS DREJTUESE TË SHQIPËRISË STALINISTE MBI INTEGRIMIN EVROPIAN\*

### Regjimi politik dhe burimet e analizës mbi integrimin evropian

Pas Luftës së Dytë Botërore regjimi politik në Shqipëri u formësua sipas modelit sovjetik të qeverisjes të frymëzuar nga marksizëm-leninizmi. Në shkencat politike, marksizmi-leninizmi konsiderohet si ideologjia zyrtare e shtetit sovjetik dhe e të gjitha partive komuniste besnike ndaj Stalinit dhe pasardhësve të tij. Marksizmi dhe leninizmi sipas një përcaktimi më konkret nuk është as marksizëm e as leninizëm, as sintezë filozofike, por një term artificial që Stalini e përdori personalisht kur u botua për herë të parë më 1938 *Historia e Partisë Komuniste të BS (Bolshevike)*, për të përcaktuar se çfarë është komunizmi dhe çfarë nuk është komunizmi. *Mund të thuhet se marksizmi është teoria dhe komunizmi praktika - ose ndryshe që të dyja janë përzierje te ndërlikuara të teorisë dhe praktikës.*<sup>1</sup> Si ideologji totalitare marksizëm-leninizmi u bazua tek analiza sociologjike e Marksit mbi përvojën politike dhe ekonomike të pak vendeve të përparuara të Evropës Perëndimore në mesin e shek. XIX, si Franca dhe Anglia. 50 vjet më pas, Lenini e përshtati marksizmin për transformimin e thellë ekonomik dhe politik të një vendi të prapambetur si Rusia cariste. Ai me idetë e tij politike radikale mbi organizimin e një “rendi të ri shoqëror” në krye të partisë bolshevike zbatoi në Rusinë bolshevike një eksperiment të ri utopik, i pari në historinë njerëzore me pasoja të rënda shoqërore. Në krahasim me partitë tradicionale apo individë fanatikë që aspironin të transformonin shoqërinë, *bolshevikët në të vërtetë ishin më të organizuar*

---

\* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Rrugëtimi i shtetit të pavarur shqiptar nga krijimi drejt integritit evropian”, organizuar nga Instituti i Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë, më 27 nëntor 2017.

<sup>1</sup> Roger Eatwell & Anthony Wright, Edited by, *Contemporary Political Ideologies*, San Francisco: Westview Press Boulder, 1993, p. 100.

*dhe më të disiplinuar; ndërsa terrorin dhe vrasjet ata i konsideronin si pjesë të misionit të tyre.*<sup>2</sup>

Në Shqipëri ky model regjimi u zbatua, por i ndërtuar mbi baza specifike nacionale dhe i përshtatshëm për një shoqëri të prapambetur, patriarkale, rurale, të izoluar nga ana gjeografike dhe historikisht të dominuar nga fuqi të huaja. Në këto kushte social-ekonomike, regjimi stalinist shqiptar mori trajta më të ashpra politikisht në krahasim me të gjitha vendet e Evropës Lindore që huazuan modelin sovjetik të qeverisjes. E gjithë shoqëria shqiptare e ka ndërjet thellë ndikimin e një regjimi të tillë politik. Psikologjikisht, opinioni publik shqiptar dhe elita e tij intelektuale u ndikua fort nga propaganda zyrtare e regjimit komunist, i cili i paraqiste gjërat në një mënyrë ekstremisht radikale, bardhë e zi. Në një regjim të tillë nuk kishte vend për asnjë pozitë ose qëndrime politike të ndërmjetme. Në politikën e brendshme, kushdo që vinte në diskutim zgjidhjet politike të regjimit, shihej fillimisht si kundërshtar dhe më pas armik, ndërsa në politikën e jashtme, më së paku, mund të themi se ai klasifikohet si i dyshimtë dhe më pas si tradhtar.

Në këto kushte social-politike nuk mund të flasim për ekzistencën e ndonjë elite politike me pikëpamje pluraliste, të përbërë nga rryma të ndryshme mendimi politik dhe ideologjik, pa folur për grupe ose parti politike. Ajo elitë intelektuale dhe politike që ekzistonte nga e kaluara në momentet e para të vendosjes së regjimit, u asgjësua shpejt dhe më pas ajo çka mbeti prej saj u akomodua gradualisht me vizionin dominues të Partisë Komuniste Shqiptare dhe të udhëheqësit të saj Enver Hoxha si dhe të bashkëpunëtorëve të tij më të afërt. Në këto rrethana unë do të preferoj të flas për elitë drejtuese në një kuptim fort të ngushtë të fjalës, e lidhur kjo me qeverisjen e vendit nga maja e piramidës partiake e cila diktonte në çdo nivel institucional qeveritar, kulturor dhe akademik, ideologjinë e saj totalitare. Konceptet dhe pikëpamjet e Hoxhës si kreu i regjimit në këtë aspekt janë totalisht dominuese dhe imponuese në drejtimin politik dhe intelektual të vendit, brenda dhe jashtë.

Politika e jashtme e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore u formua në sfondin e një tensioni politik në rritje mes Lindjes dhe Perëndimit, dy grupime ideopolitike me rezonancë globale të drejtuara nga dy superfuqitë e kohës, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rendi ndërkombëtar i formuar në kontekstin ideologjik dhe

<sup>2</sup> Simon S. Montefiore, *Stalin i Ri*, Tiranë: 55, 2010, f. 525.

gjeopolitik të periudhës së pasluftës ishte dypolar për gati 5 dekada. “Ky rend duopol dhe dypolar i Luftës së Ftohtë, që në shumë aspekte ishte më i qëndrueshëm, por që karakterizohej nga superfuqi që reagonin e mbi reagonin ndaj çdo lëvizje të njëra-tjetrës.”<sup>3</sup> Pikëpamja mbizotëruese e studiuesve (realistë) të marrëdhënieve ndërkombëtare është se siguria ruhet më mirë në një botë bipolare se sa në një botë multipolare, por për fuqitë e vogla ajo cenon sovranitetin dhe pavarësinë duke i kthyer ato në satelitë dhe në varësi të Fuqive të Mëdha. Për një fuqi të vogël si Shqipëria, rendi dypolar i pasluftës (1947-1991) shtroi alternativa ekstreme në zgjedhjet e aleancave ndërkombëtare. Shqipëria shumë shpejt u bë një nga vendet ku Lufta e Ftohtë mes dy Blloqeve ishte mjaft e ashpër duke mos lënë vend për alternativa politike në planin ndërkombëtar, të cilat mund të rezultonin më me përfitim në drejtim të begatisë ekonomike të vendit dhe të përparimit shoqëror.

Në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje si Jugosllavia, Greqia apo Italia, mbizotëronte një mosbesim i thellë, i ndikuar fort nga e kaluara historike. Në rastin e Fuqive të Mëdha, si ndaj Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara dhe ndaj BRSS (pas vitit 1961), që dyshoheshin fort se mbështesnin politikat armiqësore të fqinjëve, politika e jashtme e Shqipërisë mbeti refraktare duke mohuar çdo lloj dialogu dhe kontakti diplomatik. Skepticizmi ndaj qëllimeve të tyre, i përforcuar edhe nga përvoja ndërkombëtare e pas vitit 1945, ushquu tek drejtuesit komunistë shqiptarë një perceptim thujse paranojak për botën e jashtme që i rrethonte. Udhëheqësit shqiptarë për shkaqe ideologjike të lidhura me natyrën internacionaliste të mesazhit marksist-leninist e kanë mohuar ndikimin nga nacionalizmi, por “*ky faktor ka qenë pa dyshim përcaktuesi më i rëndësishëm i politikës së jashtme të Tiranës.*”<sup>4</sup> Këta faktorë kanë shërbyer jo vetëm për të përcaktuar natyrën e regjimit politik shqiptar me një përmbajtje e formë nacional-komuniste, por edhe për të frymëzuar ide e analiza specifike radikale në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare.

Tema e integritimit evropian dhe ideja e "Evropës së Bashkuar", në këto rrethana ka zënë një vend të veçantë në shënimet e Enver Hoxhës të njohur si *Ditari Politik*. Në mungesë të një leximi të thelluar të dokumenteve të Arkivit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe sidomos të

<sup>3</sup> Fared Zakaria, *Bota Pas-Amerikane*, Tiranë: IDK, 2009, f. 10.

<sup>4</sup> Elez Biberaj, *Shqipëria dhe Kina. Një aleancë e pabarabartë*, Tiranë: AIIS, 2014, f. 21.

fondit personal të kreut të regjimit shqiptar, Enver Hoxhës, jam mjaftuar me shfrytëzimin e shënimeve në formë ditari personal për çështjet ndërkombëtare, të cilat janë shkëputur nga *Ditari Politik* i tij. Këto shënime, pa dyshim të redaktuara më pas, nuk kanë vlerën e një dokumentacioni autentik arkivor. Por analizat politike që i shoqërojnë, kanë një vlerë me rëndësi pasi ato pasqyrojnë më së miri tendencat e orientimit ideologjik dhe strategjik të regjimit komunist në Shqipëri. Përmbajtja e shënimeve që formojnë *Ditarin Politik*, janë fort përfaqësuese sidomos për propagandën ideologjike dhe politike të regjimit brenda dhe jashtë vendit. Vëllimet e ndryshme që përbëjnë *Ditarin për Çështjet Ndërkombëtare* janë konceptuar në mënyrë kronologjike dhe fillojnë nga viti 1958 deri më 1981, të botuara në vitet 1981-1985 nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së. Nga ky ditar janë shkëputur dhe janë botuar si libra më vete *Shënime për Kinën* në 2 vëllime më 1979 dhe vëllimi me titull *Superfuqitë* më 1986.

Problemet e integritimit evropian janë të pranishme në shënimet e liderit komunist shqiptar që nga fillimi i viteve '70, kur vetë Komuniteti Evropian kish filluar tashmë t'i kushtonte më shumë rëndësi marrëdhënieve të tij të jashtme. Duhet mbajtur parasysh, se frazeologjia e përdorur në "Ditarin" e Enver Hoxhës është në mënyrë tipike shprehje e mendimit dhe ideologjisë marksiste-leniniste i pleksur ngushtë me shqetësimet për sigurinë kombëtare dhe pushtetin personal të *caudillos* shqiptar.

### **Mbi natyrën e integritimit evropian dhe perspektivën e tij**

*Komuniteti Ekonomik Evropian* (KEE) së bashku me *Euro-atomin* (Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike) u krijuan me nënshkrimin e Traktateve të Romës më 25 mars 1957 me një afat të papërcaktuar kohor. Gjashtë shtetet themeluese të KEE (Franca, RF e Gjermanisë Perëndimore, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu), i njohur që në fillimet e tij si Tregu i Përbashkët, në pjesën hyrëse të dokumentit themelues (*Preambula*), nuk harruan të theksonin objektivat e tyre politike: afirmimin e "*ruajtjes së paqes dhe lirisë*" dhe vendosjen e

*“themeleve të një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë mes popujve evropianë”.*<sup>5</sup>

Këtë aspekt themelor të qëllimit të krijimit të KEE që lidhet me shqetësimin kryesor të vendeve evropiano-perëndimore në forcimin e paqes me anë të bashkëpunimit në kontinentin e vjetër të rrënuar nga luftëra të përgjakshme, E. Hoxha nuk e përmend fare, por thekson qëllimisht në mënyrë krejt të njëanshme dhe konform mendimit marksist, pikësnyimin kapitalist të këtij organizmi për të siguruar *“sa më shumë fitime për borgjezinë kapitaliste të secilit vend anëtar, si dhe për të forcuar ekonominë kapitaliste të çdo shteti të veçantë dhe të gjitha këtyre shteteve si një bashkësi ekonomike”.*<sup>6</sup> Krejt ndryshe vlerësohen përpjekjet për një Evropë të bashkuar nga Konrad Adenauer, një nga etërit themelues të saj. Brenda pak vitesh shkruan kancelari gjerman në kujtimet e tij, u shënuar një kthesë në marrëdhëniet mes popujve evropianë, që askush nuk e kish menduar përpara 10 vitesh. *“Bashkimi i Evropës kishte një rëndësi që tejkalonte shumë kufijtë e saj, - shkruan ai, - sepse një Evropë e bashkuar do të ishte përherë në mbrojtje të lirisë dhe në ruajtjen e paqes”.*<sup>7</sup>

Traktati themelues i KEE organizon në mënyrë të detajuar vënien në zbatim të Bashkimit Doganor mes 6 vendeve anëtare, duke filluar nga 1 janari i vitit 1959, me disa etapa gjatë një periudhe tranzitore prej 10 vjetësh. Ai parashikon realizimin e katër parimeve të lirisë për qarkullimin e mallrave, kapitaleve, fuqisë punëtore si dhe lirinë e zhvendosjes së veprimtarisë prodhuese të sipërmarrjeve, punonjësve të pavarur dhe shërbimeve. Parashikohet gjithashtu vendosja e rregullave bazë për zhvillimin e një konkurrence të ndershme; ndalohet dumpingu si dhe në disa rrethana, kartelet dhe monopolet. Traktati parashikon edhe hartimin e politikave të përbashkëta (tregtare, bujqësore, transporte), por nuk bëhet fjalë për politika të përbashkëta ekonomike, industriale apo monetare. *Në traktat trajtohen edhe çështjet sociale, ku parashikohet një bashkëpunim mes 6 vendeve anëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës, krijimin e një Fondi social evropian me qëllim*

<sup>5</sup> Charles Zorgbibe, *Histoire de la construction européenne*, Paris: PUF, 1993, p. 44.

<sup>6</sup> Enver Hoxha, *Shënime për Kinën*, vëll. II (1973-1977), Tiranë: 8 Nëntori, 1979, f. 114.

<sup>7</sup> Gérard Bossuat, *Les fondateurs de l'Europe unie*, Paris: Ed. Belin, 2001, p. 163.

*kryesisht financimin në bashkëpunim mes shteteve anëtare, e riaftësimit të papunëve.*<sup>8</sup>

Këto janë aspekte shumë të rëndësishme të veprimtarisë së KEE, që synojnë harmonizimin e shkëmbimeve tregtare dhe nxitjen e veprimtarisë prodhuese në vendet anëtare, duke shmangur deformimet e tregut dhe përmirësuar nivelin e jetesës edhe të punëtorëve. Por Hoxhës i vjen mbarë të theksoj vetëm anën e fitimit për kapitalin dhe nuk merr fare në konsideratë këto aspekte të rëndësishme të veprimtarisë ekonomike e sociale të Komunitetit. Në vendet e zhvilluara të Perëndimit ndërmarrjet, kompanitë, konsiderohen si një organizatë ekonomike, por ato janë gjithashtu dhe institucione politike. Nga njëra anë ato paguajnë njerëzit që jetojnë një pjesë të madhe të jetës së tyre në gjirin e saj, kështu që ato organizojnë bashkëjetesën e kësaj bashkësie njerëzish. Institucioni i ndërmarrjes pra ka efekte mbi njerëzit dhe jetën në komunitet. Nga kjo pikëpamje, Hoxha bën një analizë krejt të përciptë dhe të thatë të veprimtarisë së KEE kur shkruan: “*Tregu i Përbashkët Evropian kur u krijua kishte për qëllim zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare ndërmjet shteteve anëtare ... Natyrisht, tok me rregullimin e problemit të marrëdhënieve doganore, u sistemuan dhe një sërë çështjesh të tjera, si problemi i çmimeve, problemet monetare e të tjera marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe*”.<sup>9</sup>

Në qershor të vitit 1979 u zgjodh për herë të parë me votim të përgjithshëm, Parlamenti Evropian. Çështja e përfaqësimit demokratik të popujve evropianë në një parlament me zgjedhje të drejtpërdrejta e të përgjithshme parashikohej që në Traktatet e Romës. Pushtetet e këtij parlamenti ishin të kufizuar dhe shtetet anëtare nuk ranë dakord për të vendosur një sistem unik zgjedhor për të gjithë vendet e komunitetit. Pavarësisht, “*zgjedhja me votim të përgjithshëm të një Parlamenti Evropian përmirësoi përfaqësimin demokratik të qytetarëve. Zgjedhjet krijuan mundësinë e një informacioni të rëndësishëm për qytetarët e vendeve anëtare*”.<sup>10</sup> Në fushatën zgjedhore morën pjesë personalitete politike me rëndësi, përfaqësues të së majtës, si Willy Brand, Enrico

<sup>8</sup> Ch. Zorgbibe, *Histoire de la construction européenne ...*, aneks: Teksti i Traktatit të Romës, pp. 44 - 47; Marie - Thérèse Bitsch, *Histoire de la construction européenne de 1945 à nos jours*, Paris: Ed. Complexe, 2004, f. 119.

<sup>9</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën ...*, f. 114.

<sup>10</sup> G. Bossuat, *Les fondateurs de l'Europe unie ...*, p. 205.

Berlinguer, Simone Veil, aktiviste politike e njohur për të drejtat e grave në Francë, që u bë dhe kryetarja e parë e këtij parlamenti të ri evropian.

Aspekti i demokratizimit të jetës politike dhe funksionimit të institucioneve evropiane nuk bën pjesë në shqetësimet dhe analizat e Hoxhës. Përkundrazi, rasti është ideal për të zvogëluar rëndësinë e tij si institucion i përfaqësimit të mendimit demokratik në Evropë, por dhe për të evidentuar dobësitë fillestare të organizimit politik të KEE. Kritikantët e tij, Hoxha i bazon tek konceptet marksiste të funksionimit të “shtetit kapitalist” si “superstrukturë e shoqërisë borgjeze”. *“Përshtypja e përgjithshme është se interesi i zgjuar nga ky parlament dhe rëndësia e tij janë minimale dhe formale - shkruan Hoxha. Fushata zgjedhore cilësohet e zbehtë dhe rezultati i pjesëmarrjes në votime një fiasko e vërtetë, vëren Hoxha, sepse përqindja e votuesve në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore ishte shumë ulët”*.<sup>11</sup> Parlamenti si institucion qendror i jetës politike nuk përfillet në funksionet e tij dhe synohet të zhvlerësohet krejt nga roli tij institucional, pasi mendohet se është *nën urdhrat e borgjezisë e kapitalizmit, trustet ... të cilët janë në gjendje të ushtrojnë presion mbi këto parlamente dhe qeveri*.<sup>12</sup>

Udhëheqësi shqiptar është i varur tërësisht në gjykimin e tij nga sociologjia marksiste dhe interpretimi i historisë si një luftë klasash antagonistë. Ai nuk shikon asnjë alternativë tjetër në jetën politike të shoqërisë veçse revolucionin proletar ose socialist sipas versionit të tij utopik e radikal. Hoxha për arsye propagande politike të brendshme fut në një “thes” si shtetet kapitaliste evropiane dhe ato revizioniste (lexo: shtetet e bllokut sovjetik) dhe ekzagjeron qëllimisht karakterin e organizimit ndërkombëtar në Evropë të ndarë në dy kampe (KEE/NATO vis-à-vis KNER/Pakti Varshavës), të cilët të dy konsiderohen armiqësor për regjimin e tij stalinist. Ai shkruan se, këto shtete kanë *“brendapërbrenda kontradikta të forta klasore, të cilat e bëjnë të zorshëm jo vetëm për unitetin e jashtëm, por edhe atë të brendshëm”*.<sup>13</sup>

Projekti i Jean Monnet dhe etërve të tjerë të idesë mbi një Evropë të bashkuar që synonte krijimin e “Shteteve të Bashkuara të Evropës” nga shumë pikëpamje nuk mund të shëmbëllente me formimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga ky këndvështrim mund të mendohej jo pa të

<sup>11</sup> Enver Hoxha, *Superfuqitë*, Tiranë: 8 Nëntori, 1986, f. 489.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 489-490.

<sup>13</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f. 117.

drejtë, se është e vështirë “*që shtetet evropiane të integrohen në një organizëm të vetëm apo të asimilohen me njëri-tjetrin*”, vëren Hoxha. *Çdo shtet në Evropë ka personalitetin e vet si një komb i formuar historikisht, me shekuj. Secili prej tyre ka historinë e vet, një zhvillim të ndryshëm social, ekonomik dhe kulturor të ndryshëm prej të tjerëve.*<sup>14</sup> Deri këtu analiza e Hoxhës është korrekte, pasi theksohet identiteti etno-kulturor i shteteve kombëtare evropiane të formuara gjatë historisë. Por kjo analizë është e cunguar dhe nuk është e plotë. Ajo dëshmon për një vizion miop dhe për një qasje pesimiste të perspektivës së integritimit evropian vështruar nga këndvështrim utopik i të ardhmes komuniste të njerëzimit.

Pikëpamja federaliste për krijimin e Evropës së Bashkuar natyrisht që nuk arriti të dominojë plotësisht në radhët e elitës drejtuese evropiane, si në rastin e 13 kolonive britanike në kontinentin amerikan, që formuan më 1787 Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Federalizmi kërkon që shtetet t’i nënshtrohen një autoriteti që qëndron mbi ata: ky është parimi i *supranacionalitetit* ose mbikombëtarizmit. Pikëpamja tjetër, që kundërshton të parën, është “Evropa e Shteteve”, ku secili shtet ruan sovranitetin e tij. Kjo ishte pikëpamja e De Gaulle-it pasi erdhi në pushtet më 1958, e cila theksonte “*delegimin e pushtetit që duhet ushtruar jo nga një organ i pavarur, por nga përfaqësues të shteteve në nivel të lartë, që gëzojnë të drejtën e vetos... dhe ... në plan afat-gjatë ky objektiv ishte konfederata*”.<sup>15</sup>

Në vetvete organizimi institucional i Bashkimit Evropian mbështetet në të dy qasjet: **integrimi**, kur shtetet pranojnë t’i nënshtrohen rregullave të institucioneve mbi-kombëtare, vendimet e të cilave zbatohen direkt si në rastin e tregut të brendshëm; dhe **bashkëpunimi**, kur shtetet marrin vendime të përbashkëta në veprimtari politike dhe në disa sektorë të ekonomisë. Kjo ka qenë dikotomia e funksionimit të KEE, e cila është e vlefshme edhe sot e kësaj dite: një Bashkim Evropian i dyzuar mes integritimit mbi-kombëtar dhe bashkëpunimit ndërshtetëror.

---

<sup>14</sup> *Po aty.*

<sup>15</sup> M.-Th. Bitsch, *Histoire de la construction européenne de 1945 ...*, f. 135.



## Roli i KKE si “superfuqi e re kapitaliste dhe imperialiste”

Në fillim të viteve 1970, Komuniteti Evropian duke përfituar nga kriza e dollarit (gusht 1971) dhe humbjet ushtarake të SHBA në Azinë Juglindore (Vietnam & Kamboxhia), forcoi pozicionet e brendshme politike. Kjo, sipas mendimit të Hoxhës, e bëri KEE të aspirojë më shumë si një organizëm me vete dhe të tentojë të bëhet “një superfuqi e re kapitaliste dhe imperialiste”.<sup>16</sup> Është kjo "Evropa e Bashkuar" që zgjon interesin e kreut të regjimit shqiptar, pasi një Evropë e fuqishme ilustron mjaft mirë idenë staliniste të rivalitetit imperialist, dobësimin të Perëndimit dhe përfitimeve që mund të nxjerrin forcat socialiste në Evropë dhe në botë.

Në konceptet e liderit shqiptar si dishepull i Leninit, pa dyshim që një rol i tillë i KEE i jep atij një karakter reaksionar. Lenini ka shkruar rreth një shekull më parë për krijimin e “Shteteve të Bashkuara të Evropës”, duke theksuar karakterin e tyre të përkohshëm dhe reaksionar. “*Sigurisht ka mundësi të lidhen marrëveshje të përkohshme midis kapitalistëve dhe midis shteteve. Nga kjo anë, ka mundësi të krijohen edhe...*” Shtetet e Bashkuara të Evropës” si një marrëveshje e kapitalistëve evropianë ... po për çfarë? Vetëm e vetëm për të shtypur së bashku socializmin në Evropë, për t’i mbrojtur së bashku kolonitë e grabitura, kundër Japonisë e Amerikës.”<sup>17</sup> Në thelb analiza që bën Hoxha nuk ndryshon nga ajo e gurusë bolshevik. Përkundër vendimeve të supozuara për të vepruar në unitet mes anëtarëve të KEE, në fakt ka një ndarje të madhe mes tyre, shkruan Hoxha. "Evropa e Bashkuar", sipas tij, është një organizëm politik-organizativ-ekonomik i koncerneve të mëdha dhe shoqërive të përbashkëta të këtyre shteteve. Dhe së fundmi ai thekson se, kapitalistët e mëdhenj ... do të përdorin organizmat e kësaj "Evrope të Bashkuar" si mjet lufte për dominim."<sup>18</sup>

Sipas gjykimit të E. Hoxhës dhe këtu ai ka të drejtë, të gjitha përpjekjet për integrim ju mundësojnë këtyre vendeve të rrisin potencialin e tyre të përbashkët ekonomik. Ky është një faktor i domosdoshëm për ta bërë KEE-në një superfuqi. Por kjo nuk mjafton për

<sup>16</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f. 116.

<sup>17</sup> Vladimir I. Lenin, *Vepra të zgjedhura*, vëll. II, Tiranë: 8 Nëntori, 1974, f. 257-258.

<sup>18</sup> E. Hoxha, *Superfuqitë...*, f. 490.

t'u bërë, mendon ai. Kjo "Evropë e bashkuar" nuk ka peshë në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes dhe veçanërisht në fuqinë bërthamore të zotëruar nga dy superfuqitë. Nga ana tjetër, gjykon Hoxha, “në këtë "Evropë të bashkuar" *kontradiktat e thella politike dhe ekonomike midis shteteve që e përbëjnë atë, janë të një rëndësie të tillë që dhjetëra vjet nuk do të ishin të mjaftueshme që ajo të arrinte potencialin ekonomik dhe ushtarak Shtetet e Bashkuara të Amerikës*".<sup>19</sup> Kjo ide është e vërtetë, por vetëm pjesërisht.

Evropa ende sot nuk ka një kapacitet mbrojtës ushtarak të pavarur nga amerikanët dhe NATO. Por në aspektin ekonomik, KEE që në vitet 1970 sfidonte fuqinë tregtare dhe ekonomike të SHBA. Ekspertët e analistët sot pranojnë pa mëdyshje se “në skenën ndërkombëtare, *Bashkimi Evropian shfaqet një fuqi botërore që ka interesat e tij për t'u mbrojtur. Pjesa e tij në shkëmbimet ndërkombëtare është e barabartë me SHBA dhe Kinën ... Tregu i brendshëm është tregu më i madh i harmonizuar në botë*".<sup>20</sup> Ato që Hoxha i konsideron sipas konceptit marksist-leninist kontradikta të thella, nuk janë veçse mosmarrëveshje mes anëtarëve të BE që kanë shoqëruar përherë procesin e integritit evropian, që nga krijimi i tij deri sot, aq sa mund të thuhet se ajo është krijesë e dalë nga krizat dhe nga zgjidhjet e tyre. Vetë ai që konsiderohet “babai i Evropës” Jean Monnet e thekson këtë ide të nxjerrë nga përvoja e tij e gjatë në shërbim të projektit për krijimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës: “*gjithmonë kam menduar – shkruan Monnet në kujtimet e tij-se Evropa do të bëhet nga krizat dhe se ajo do të ishte përgjigja e zgjidhjeve për këto kriza*”.<sup>21</sup>

“Evropë e Bashkuar” inkurajohet dhe mbështetet nga Fuqitë e Mëdha të Evropës Perëndimore, vëren Hoxha, dhe megjithëse ai i cilëson politikat e tyre ekspansioniste, duket se i sheh me një lloj simpatie, veçanërisht Francën golliste, për qëndresën që i bëjnë ShBA. “*Franca e Pompidusë dhe më pas ajo e Zhiskarit, shkruan E. Hoxha, jo vetëm përpiqet ta ruajë dhe të zhvillojë më tej forcën e saj bërthamore, por ka filluar më aktivisht të ringjallë politikën e vjetër kolonialiste me petka neokolonialiste në Afrikën frankofone, Lindjen e Mesme dhe Lindjen e*

<sup>19</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f. 117.

<sup>20</sup> François de Teysier & Gilles Baudier, *La construction de l'Europe*, PUF, Paris: 2014, p. 107.

<sup>21</sup> Jean Monnet, *Mémoires*, Paris: Fayard, 1976, p. 488.

*Largët*".<sup>22</sup> Forcat e saj ekonomike nuk lejojnë Francën të konkurrojë të tjerët, por me aq sa mundet, ajo e bën këtë. Qëndrimi i Francës ndaj Shteteve të Bashkuara nuk është më i kohës së De Gaulle-it dhe Pompidou-s. Ky qëndrim është zbutur disi, edhe pse mbetet një element pavarësie, vëren Hoxha. Anglia gjithashtu shkruan ai, vazhdon të forcojë disi ndikimin e humbur ekonomik në vendet e Komonuelthit, ndërkohë që Gjermania Perëndimore po ndërhyt ekonomikisht në Evropën Qendrore, në Ballkan (përveç Shqipërisë), në Turqi dhe kudo ku mundet rreth e rrotull, përfundon analizën e tij, Hoxha.<sup>23</sup> Me mburrje, Hoxha thekson veçimin e Shqipërisë nga ky zgjerim i ndikimit gjermano-perëndimor, pozitë e cila pak vite më pas, me rastin e kërkesës së qeverisë së Tiranës për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bonin, do të ndryshojë dukshëm, por me vonesë dhe pa shumë dobi.

KEE në fillesat e procesit të integritit nuk mund të shpërfillte ekonominë e fuqishme amerikane dhe të mos rreshtohej me atë të Shteteve të Bashkuara. Pas Luftës së Dytë Botërore, amerikanët, nëpërmjet ndihmës që i dhanë Evropës Perëndimore, kontribuuan në rimëkëmbjen e saj ekonomike, pa harruar në asnjë kohë interesat e tyre, të cilat ishin dhe mbetën të konsiderueshme në këtë fushë, vëren Hoxha. Kështu, pas krijimit të Tregut të Përbashkët Evropian, nga një anë Shtetet e Bashkuara bënë përpjekjet e veta për t'i imponuar këtij organizmi politikën e tyre ekonomike dhe në anën tjetër vendet anëtarë të Tregut të Përbashkët vazhduan përpjekjet e tyre për t'u çliruar nga tutela amerikane. "*Lindën kështu kontradikta midis tyre, të cilat erdhën duke u thelluar, shkruan ai në ditarin e tij*".<sup>24</sup>

Zhvillimi i procesit të integritit evropian dhe "analiza" e tij në vazhdim bëhen për të demonstruar besueshmërinë e koncepteve skematike ideologjike në shpjegimin e rivalitetit brenda këtij procesi. Në këtë drejtim, sipas Hoxhës, shpjegohet qëndrimi i rezervuar i Francës në lidhje me KEE-në dhe parlamentin e saj. Ajo e sheh qartë-shkruan ai- se Gjermania Federale dominon dhe do të dominojë në këtë Komunitet dhe kjo nuk është se e bën atë të kënaqur. Sa për amerikanët, ata nuk e pëlqejnë KEE, parlamentin e tij dhe qeverinë e tij. Në një farë mase, "*uniteti*" i këtyre monopoleve dhe shoqërive të përbashkëta, edhe pse

<sup>22</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f. 116.

<sup>23</sup> *Po aty*.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 114-115.

amerikanët janë të angazhuar plotësisht, rrezikon t'i bëjë disi hije ekspansionit amerikan.<sup>25</sup> Shtetet e Bashkuara e shohin Gjermaninë Federale dhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore, secilin më vete ose si tërësi, si konkurrentë të fuqishëm dhe kjo nuk është se atyre kjo ju pëlqen, vëren jo pa të drejtë kreu i regjimit shqiptar.

Lufta e Ftohtë mbulonte disi këto kontradikta, vë në dukje Hoxha, sepse anëtarët e Tregut të Përbashkët, edhe nëse filluan të tregojnë seriozisht dëshirën e tyre për pavarësi ekonomike, megjithatë u detyruan të jetojnë, për nevojat e mbrojtjes së tyre, nën ombrellën atomike amerikane. Natyrisht, vazhdon analizën ai, Shtetet e Bashkuara kanë ditur të shfrytëzojnë në favor të tyre ndjenjën e frikës së një lufte të mundshme me sovjetikët që shkaktonte ajo në vendet e KEE. Politika sovjetike e Hrushovit në BRSS, sipas Hoxhës, e çliroi borgjezinë kapitaliste nga frika e revolucionit dhe komunizmit dhe e lejoi atë të merrte frymë lirisht. Kjo politikë e cila shihej si tradhti nga E. Hoxha, “përçau forcat revolucionare në të gjithë botën dhe largoi perspektivën e revolucionit, favorizoi nacionalizmin. Kjo situatë mendon ai, krijoi për borgjezinë kapitaliste mundësinë për të forcuar pozicionet e brendshme të dobëta dhe për të ndërmarrë kombinime të reja midis shteteve në arenën ndërkombëtare”.<sup>26</sup> Ky këndvështrim sektar lidhet ngushtë edhe me natyrën diktatoriale të regjimit politik në Shqipëri dhe pozitën e ngurtë të kreut të këtij regjimi, i cili e shihte me frikë të madhe dhe jo të favorshme për vendin dhe pushtetin e tij, situatën ndërkombëtare.

Në këto rrethana, Evropa Perëndimore kish rifituar kurajë, vë në dukje Hoxha. Franca me De Gaulle-n, zbatonte një politikë më të pavarur ndaj amerikanëve dhe anglo-saksonëve në përgjithësi. De Gaulle u largua nga strukturat ushtarake të NATO-s, duke u kufizuar vetëm në respektimin e angazhimit politik të traktatit të aleancës. Ai gjithashtu mendonte për një Treg të Përbashkët dhe një për "Evropë të Bashkuar", e cila, pa lënë jashtë Gjermaninë e Adenauer-it, të ishte megjithatë e dominuar nga Franca. “De Gaulle ishte i fryrë nga një nacionalizëm i zjarrtë dhe ai gjithashtu këtë e kërkonte nga partnerët e tij, por me kusht që kjo ndjenjë të kanalizohet në një Evropë siç e ëndërronte ai”,<sup>27</sup> shkruan Hoxha në ditarin e tij politik.

<sup>25</sup> E. Hoxha, *Superfuqitë ...*, f. 490

<sup>26</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f. 115.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 116.

Planet e De Gaulle-it, Hoxha i mendon si të paarritshme, sepse në radhë të parë sipas tij, partnerët e Francës gjithashtu kishin qëllimet dhe frikën e tyre. Të gjitha këto vende nuk e konceptonin në të njëjtën mënyrë rolin e Shteteve të Bashkuara në Evropë dhe në botë. Gjermania Perëndimore në radhë të parë, e ndarë në atë kohë nga pjesa tjetër e vendit, preferonte të bënte disa lëshime për Shtetet e Bashkuara në fusha të tjera, pa ndjekur rrugën e Francës, atë të heqjes dorë nga mbrojtja ushtarake amerikane. Gjermania dhe partnerët e tjerë evropianë nuk i kushtonin ndonjë rëndësi të madhe fuqisë atomike qoftë të Francës apo të Britanisë së Madhe, madje as asaj të dy vendeve të marra së bashku, pasi sipas tyre kjo forcë është një "shkurtabiq" para forcës bërthamore sovjetike ose amerikane. Ky realitet gjeopolitik duket se nuk shihet pozitivisht nga kreu i regjimit stalinist shqiptar. Ky raport forcash në Evropë nuk është i favorshëm për një vend të vogël dhe të prapambetur si Shqipëria, dhe për më tepër pa aleatë të fuqishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare.

### **Polemika shqiptaro-kineze rreth “Evropës së Bashkuar”, si refuzim i angazhimit ndërkombëtar të Shqipërisë**

Në fillim të viteve ‘70 politika e jashtme kineze pësoi ndryshime të thella. Kina hoqi dorë nga qëndrimet e skajshme të *Revolucionit Kulturor*, i cili nxori në shesh prapambetjen, dhe izolimin diplomatik. “*Duke nxjerrë mësim nga izolimi ndërkombëtar i viteve ’60, Kina përfundimisht u orientua nga një politikë me prioritet modernizimin e vendit, që natyrisht do shoqërohej edhe me një hapje me botën e jashtme*”.<sup>28</sup> Që në vitet 1969-1971, Pekini vendosi t’i përgjigjej propozimeve amerikane, shkruan Kissinger, “pasi ishte bërë nevojë strategjike rifillimi i kontakteve me SHBA”.<sup>29</sup> Kina u angazhua në një proces detante dhe normalizimi marrëdhëniesh me SHBA, Japoninë, Komunitetin Evropian dhe vende të ndryshme pro-perëndimore të Botës së Tretë.

Në këto rrethana të reja ndërkombëtare, udhëheqësit e Kinës komuniste filluan të bënin deklarata në favor të integritetit të Evropës. Ata mbështetën zgjidhjet politike të bëra nga KEE-së dhe inkurajuan

<sup>28</sup> Petrit Nathanaili, “Aleancat lindore, zgjedhje strategjike e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë”, në *Studime mbi Totalitarizmin dhe Tranzicionin në Shqipëri*, bot. Konrad Adenauer Stiftung, Tiranë: 2016, f. 98.

<sup>29</sup> Henry Kissinger, *Për Kinën*, Tiranë: Toena, 2013, f. 236.

"kundërpeshën" e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare përballë dy superfuqive, veçanërisht në lidhje me BRSS. Prandaj, për të mbështetur orientimin e KEE, që synon hegjemoninë për t'u bërë një "superfuqi", siç po bën Kina, Hoxha gjykon se nuk është e drejtë në planin parimor. Duke vepruar në këtë mënyrë, sipas mendimit të Hoxhës, *"do të thotë të harrosh rrugën e revolucionit dhe të hysh në ingranazhin e lojës politike të dy superfuqive ... Kina gabon kur predikon se armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik dhe se Shtetet e Bashkuara janë më pak të rrezikshëm"*.<sup>30</sup>

Nga mesi i viteve '70, Shtetet e Bashkuara kishin filluar të ndjenin dobësimin e rolit të tyre si fuqi hegjemoniste në shumë zona të globit, si Indokinë, Lindjen e Mesme, por dhe në Evropë me forcimin e rolit të KEE në planin ndërkombëtar me potencialin e saj demografik dhe tregtar. Me 256 milion banorë më 1973, kur KEE u bë me 9 anëtarë (duke u anëtarësuar Anglia, Irlanda dhe Danimarka), ato kalonin SHBA me 207 milion banorë si dhe BS me 245 milion banorë; "KEE konsolidonte dhe pozitat e saj si fuqia kryesore tregtare, me 22.6% të shkëmbimeve tregtare botërore. Kjo fuqi në rritje shqetësonte SHBA që shikonin tek KEE një konkurrent dhe po kuptonin se avantazhet politike të bashkimit të Evropës nuk kompensonin më vështirësitë e tyre ekonomike".<sup>31</sup>

Pavarësisht nga kjo pozitë delikate e SHBA në planin ndërkombëtar, në gjykimet e liderit shqiptar, ato mbeteshin një fuqi imperialiste *par excellence*. Në këto rrethana, Kina, sipas tij, gjithashtu gabohej kur ajo *"vihej në pozat e Don Kishotit ndaj Evropës së vjetër kapitaliste"*, me shpresën se do të bëhej një kundërpeshë ndaj sovjetikëve nga një anë dhe amerikanëve në anën tjetër dhe se ajo do të përfitonte nga vetë fakti se ajo mbështeste Evropën e Bashkuar. Sipas konceptit marksist-leninist të udhëheqësit shqiptar, *"kontradiktat midis imperialistëve duhet të thellohen dhe të shfrytëzohen në dobinë tonë, por vetëm nga pozitat klasore, nga pozitat e revolucionit"*.<sup>32</sup>

Liderët komunistë të Kinës, nga ana e tyre, pohonin se elita politike shqiptare pretendon se dy superfuqitë janë të rrezikshme në të njëjtën mënyrë dhe se mbivlerësojnë bashkëpunimin midis Shteteve të Bashkuara dhe BRSS duke nënvlerësuar kontradiktat mes tyre. Elita drejtuese kineze pretendonte se udhëheqësit shqiptarë mbështeten tek Lenini për të hedhur

<sup>30</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...vepër e cituar*, f. 117-118.

<sup>31</sup> M.-Th. Bitsch, *Histoire de la construction européenne...*, p. 195.

<sup>32</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën...*, f.118.

poshtë tezën e "Bashkimit Evropian", i cili e konsideronte reaksionare parullën e "Shteteve të Bashkuara të Evropës", sepse ato *në kushtet e kapitalizmit ose janë të pamundshme ose janë reaksionare*".<sup>33</sup> Argumenti kritik kinez ndaj tezës shqiptare ishte se Lenini ka shprehur kundërshtimin e tij ndaj një federate evropiane midis Rusisë, Austrisë dhe Anglisë, si tre nga perandoritë e mëdha imperialiste të kohës. "Ndërsa ne (kinezët) kemi *parasysish bashkimin e vendeve të Evropës Perëndimore*". Për kinezët, sipas interpretimit të Hoxhës, *kjo do të thotë që vendet kapitaliste të Evropës Perëndimore nuk janë reaksionare!*"<sup>34</sup>

Në realitet, kjo polemikë midis elitave drejtuese në Kinë dhe Shqipëri, dy vende me regjime komuniste totalitare, nuk ishte vetëm një debat i thjeshtë ideologjik. Në sferën kineze të ndikimit gjeopolitik, përçarja shqiptaro-kineze (1972-1978) erdhi si pasojë e refuzimit që qeveritarët shqiptarë i bënë real-politikës së qeverisë kineze e cila u realizua me afrimin e Kinës me ShBA. Politika e re e jashtme e Kinës popullore u inaugurua me rastin e takimit të kryetarit Mao me Presidentin amerikan Nixon në Pekin në shkurt 1972. "Kjo vizitë është nga të paktat raste kur një vizitë shtetërore shkakton ndryshim themelor të çështjeve ndërkombëtare".<sup>35</sup> Për udhëheqjen shqiptare ky afrim ishte shprehje e tradhtisë ideologjike të vetë teorisë së Tri Botëve të Maos dhe uljes së nivelit të angazhimit të tij ndaj internacionalizmit proletar.

Në Kinë, historia zyrtare e paraqet zbatimin në praktikë të mendimit të Mao Ce Dunit si përshtatje e marksizmit-leninizmit në kushtet e Kinës dhe si një zhvillim i leninizmit në mbarë botën. Për rrjedhojë, maoizmi (*maocedun-idea*) u bë ideologjia zyrtare shtetërore e Republikës Popullore të Kinës. Në Bllokun Komunist, kontradiktat ndërmjet ortodoksisë maoiste dhe pragmatizmit të Maos, i detyronin drejtuesit marksistë-leninistë të minimizonin madje dhe të mohonin rolin e maoizmit në veprimet e Kinës komuniste në kuadrin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në të cilën Mao propagandonte stalinizmin dhe mbështeste Partinë e Punës të Shqipërisë si shembull i respektimit strikt të ideologjisë dhe modelit stalinist.

Ky debat ideologjik maskonte një shqetësim gjeopolitik mjaft të ndryshëm për dy aleatë krejtësisht të pabarabartë mes tyre. Kina, një vend

<sup>33</sup> V. I. Lenin, *Vepra të zgjedhura ...*, vëll. II, f.256.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 407 .

<sup>35</sup> H. Kissinger, *Për Kinën...*, f. 291.

i madh, për të modernizuar ekonominë e saj dhe për të forcuar potencialin ushtarak e kishte të nevojshme të zhvillonte marrëdhëniet e saj me botën perëndimore. Ndërsa, Shqipëria, një vend i vogël dhe mjaft i brishtë për nga pozicioni i saj midis dy blloqeve kundërshtarë, Lindjes dhe Perëndimit, duhej të ruante një orientim politik me një lloj distance të baraslarguar ndërmjet dy superfuqive dhe aleancave të tyre përkatëse prej nga buronte dhe një politikë asnjëansie ose neutraliteti e Shqipërisë në raport me dy blloqet. Por ajo nuk ishte aspak pasive, por me një prirje të theksuar ideologjike ofensive ndaj kujtdo që përpiqej të cenonte pozitat e saj politike të brishta. Mjetet për të siguruar mbijetesën, që është qëllimi përfundimtar i çdo shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare, Shqipëria staliniste u përpoq ta realizonte me një prej parimeve kryesore të teorisë realiste: mbështetja në aftësitë e veta për t'u mbrojtur është më e vlefshme se sa mbështetja tek aleatët e mundshëm ose tek garancia e organizatave ndërkombëtare. Kjo është ajo çka quhet në fushën e sigurimit “*self-help*”, ku mbështetja në forcat e veta konsiderohet si mënyra më e mirë dhe më e sigurt.

Gjatë gjithë kohës së ekzistencës së regjimit stalinist në Tiranë, nuk ka pasur marrëdhënie zyrtare midis Shqipërisë dhe KEE-së. Duke pasur parasysh kulturën politike të udhëheqësit shqiptar, i cili nuk ishte aspak i gatshëm të vinte në pikëpyetje zgjedhjet e tij politike, ishte krejt e vështirë të përfytyrohej se në çfarë kushtesh mund të vendoseshin kontaktet ndërmjet Shqipërisë dhe KEE. Arsyet për të cilat regjimi politik shqiptar nuk donte të vendoste marrëdhënie me Komunitetin Evropian janë të një natyre të ndryshme dhe të shumëfishta. Para së gjithash, mosbesimi politik ndaj Fuqive të Mëdha, që përfaqësonin një sfidë për Shqipërinë si një fuqi e vogël dhe pavarësinë e saj. Por edhe rreziqet politike që paraqisnin për një vend të vogël e të pazhvilluar nga ana industriale ndërmarrjet e mëdha kapitaliste të vendeve të KEE-së, të mbështetura nga elita politike, qoftë në Bruksel apo në kryeqytete të tjera të Evropës Perëndimore. Vullneti i Shqipërisë staliniste ndaj integritimit evropian gjithashtu mungonte, pasi elita drejtuese kërkonte të ruante hapësirën e saj të manovrimit midis dy blloqeve në Evropë. Përkeqësimi i situatës ekonomike në Shqipëri nga fundi i viteve 1970 dhe fillimi i viteve 1980, bëri që regjimi politik në Tiranë të rishikojë marrëdhëniet e tij me vendet e Evropës Perëndimore.